




POLITIKAT NË FOKUS: LIGJI PËR FALIMENTIMIN

Rreth publikimit 'Politikat në Fokus'

'Politikat në Fokus' është publikim dymujor i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, me fokus në politika dhe sfida të ndryshme ekonomike. Ligji për Falimentimin, i miratuar në qershor të vitit 2016 është temë e këtij publikimi i cili sqaron qëllimin e këtij ligji dhe risitë e tij.

Pasqyrë e përgjithshme rreth Ligjit

Pamundësia e shoqërive tregtare për të përmbushur obligimet ndaj kreditorëve është një problem mjaft i zakonshëm në Kosovë, i cili po ndikon negativisht në zhvillimin ekonomik dhe zbatueshmërinë e kontratave. Sipas Raportit "Të Bërit Biznes" të Bankës Botërore, zgjidhja e josolvensës e falimentimit mbetet indikator i më i dobët për Kosovën, ku radhitet e 163-ta nga gjithsej 189 shtete.



(Figura 1. Raporti "Të bërit Biznes", Banka Botërore)

Për më tepër, ky raport thekson mungesën e rasteve të falimentimit dhe përmend sekuestrimin e pengut si të vetmën mënyrë që është përdorur, e cila merr deri në 2 vite për t'u përfunduar.

Rrjedhimisht, një sistem funksional i falimentimit është çelësi i suksesit për shpëtimin e bizneseve të qëndrueshme, ristrukturimin e atyre me probleme dhe rregullimin në bazë të procedurave të falimentimit për bizneset josolvente.

Në krahasim me legjisllacionin e kaluar që rregullonte procedurat e falimentimit, përkatësisht Ligji Nr. 2003/4 për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim dhe Ligji Nr. 02/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Likuidimin dhe Riorganizimin Personave Juridik, Ligji i ri për Falimentimin sjellë shumë dispozita të reja.

Në rradhë të parë, ligji i ri përfshin edhe personat fizik si debitorë, gjë e cila mungonte në legjisllacionin e kaluar. Si pasojë e kësaj, debitori individual nuk do të jetë pronar i aseteve të tij të shfrytëzuara për biznes të cilat janë administruar gjatë procedurës së falimentimit.

Së dyti, ky ligj definon dhe specifikon procedurat e përshpejtuara për lehtësirat ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe për planet e para – dakorduara. Për qëllime të ligjit për falimentimin NVM konsiderohet shoqëria tregtare e cila ka qarkullimin vjetor deri **1 milion euro** ose ka deri në **25 punëtor**.

Për më tepër, ky ligj me një kapitull të ri rregullon edhe Falimentimin Ndërkombëtar, gjë e cila nuk ishte e mbuluar nga ligjet paraprake.

Qëllimi dhe fushëveprimi i Ligjit

Neni 1 i Ligjit për Falimentimin e definojnë qëllimin e këtij ligji si më poshtë:

Neni 1 **Qëllimi**

Ky ligj rregullon dhe përcakton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me falimentimin dhe josolvensën e shoqërive tregtare, dispozitat për mbrojtjen, likuidimin dhe shpërndarjen e aseteve të debitorit falimentues të kreditorët dhe dispozita për riorganizimin dhe lirimin nga borxhi për shoqëritë tregtare.

Gjithashtu, ligji përcakton kushtet dhe dispozitat për iniciimin dhe hapjen e procedurës së falimentimit ndaj debitorit në falimentim dhe zhvillimin e procedurës së tillë.

Fushëveprimi i këtij ligji mbulon edhe pasojat juridike të hapjes dhe përmbylljes së procedurës së falimentimit, riorganizimin e debitorit në vështirësi financiare si dhe pasojat e lirimit nga borxhi të debitorit pas përfundimit të suksesshëm të riorganizimit dhe likuidimit.

Kush mund të jetë debitor?

Ligji për Falimentimin është i zbatueshëm ndaj të gjitha shoqërive tregtare dhe specifikon se çdo lloj i shoqërive tregtare mund të jetë debitor përfshirë: **bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë aksionare dhe degët e shoqërive të huaja tregtare.**

Duhet të theksohet se falimentimi është procedurë gjyqësore prandaj Gjykata

Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike është kompetente për procedurën dhe shqyrtimin e rastit të falimentimit. Një gjyqtar i vetëm e gjykon rastin e falimentimit. Vendimi i Gjykatës Themelore mund të apelohej në Gjykatën e Apelit, mirëpo në bazë të ligjit shfrytëzimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk lejohet.

Inicimi i procedurës dhe hapja e rastit

Ekzistojnë dy mënyra se si mund të inicohet një rast i falimentimit nga një shoqëri tregtare. Mënyra e parë njihet si **inicimi vullnetar i rastit nga debitori** ku debitori paraqet kërkesën për riorganizim ose kërkesë për likuidim.

Mënyra tjetër njihet si **rast jovullnetar i iniciuar nga kreditorët** ku dy ose më shumë kreditorë mund të paraqesin kërkesë për iniciim të rastit ndaj një debitorit. Kjo kërkesë mund të paraqitet ndaj një debitorit kur:

- debitori ka dështuar të paguajë të paktën nga një detyrim ndaj secilit kreditor; dhe
- secilit detyrim i ka kaluar afati i pagesës prej të paktën **90** ditë;
- totali i një detyrimi është të paktën në vlerë prej **3,000** Euro; dhe
- secili detyrim është detyrim pa kushte dhe nuk është në procedurë kontestimore pranë një gjykatë ose në procedurë të arbitrazhit;
- debitori përgjithësisht nuk është duke i paguar borxhet pas arritjes së afatit të pagesës, dhe borxhi total i detyrimeve të papaguara ka tejkaluar pesëmijë euro.

Kërkesa për iniciim të procedurës së falimentimit duhet të përmbajë të paktën këto informata:

- emrin e debitorit dhe të gjithë emrat të cilët debitori i ka përdorur në 5 vitet e fundit para iniciimit të kërkesës për falimentim;

- të dhënat kontaktuese të debitorit, të cilat minimalisht duhet të përfshijnë adresën, numrin e telefonit, numrin fiskal, numrin e regjistrimit të biznesit, adresën e e-mailit dhe çfarëdo faqe në internet të cilën e ka përdorur debitori nëse ka ekzistuar një e tillë; dhe
- kur debitori është person juridik, të gjitha informatat në dispozicion për zyrtarët, drejtorët, aksionarët, menaxherët ose personat tjerë që gëzojnë kontroll ose pozita menaxheriale ndaj pronave të debitorit, së bashku me informatat kontaktuese për secilin prej tyre.

Sa i përket kërkesave të paraqitura nga kreditorët duhet të përfshijnë sa më shumë informata për debitorin që kreditorët kanë në dispozicion, por minimalisht duhet të përfshijnë emrin e debitorit dhe informata të mjaftueshme kontaktuese për debitorin me qëllim të dërgimit të njoftimeve nga gjykata.

Pasojat Juridike të hapjes së rastit

Në bazë të ligjit, pasojat juridike të hapjes së rastit janë si në vijim:

- krijimi i pasurisë së falimentimit;
- dhënia e juridiksionit ekskluziv për gjykatën për pasurinë e falimentimit dhe mbi debitorin;
- vendosja e moratoriumit,
- në procedurë të **likuidimit, shkarkohet tërësisht debitori** nga kontrolli i pronave të tij;
- në procedurë të **riorganizimit** në të cilën nuk është i emëruar dhe nuk kërkohet administratori, **debitori ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e debitorit në posedim**; dhe
- në procedurë të riorganizimit në të cilën është i emëruar administratori, shkarkohet tërësisht debitori nga kontrolli i pronave të tij dhe ngarkohet

administratori me kontroll të plotë të atyre pronave

Një kërkesë për inicim të procedurës së falimentimit vendos moratoriumin dhe urdhër ndalesë pa paralajmërim ndaj të gjitha entiteteve.

Moratoriumi është në fuqi për **120 ditë** prej momentit të hapjes së rastit, ose deri në momentin kur debitori pranon një lirim dhe mund të vazhdohet edhe pas 120 ditëve, nëse gjykata e vërteton se përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka ofruar prova të mjaftueshme se vazhdimi i moratoriumit do të kontribuonte në realizimin e qëllimeve sipas Ligjit për Falimentimin.

Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit

Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit merr në posedim të gjitha asetet, të prekshme ose të pa prekshme, së bashku me të gjitha të drejtat, kërkesat ose detyrimet ndaj atyre asetëve.

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese:

- do të administrojë me të gjithë pasurinë falimentuese;
- mund të padisë dhe të jetë i paditur në emër të pasurisë falimentuese; dhe
- kryen të gjitha detyrat e specifikuar me Ligjin për Falimentimin

Në procedurën e likuidimit Administratori i falimentimit do të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.

Në procedurë të riorganizimit, debitori është përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kur vepron si debitori në posedim mirëpo në rastet kur gjykata e emëron një Administrator të falimentimit, Administratori duhet të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese në riorganizim.

Kërkesat e kreditorëve

Në pajtim me Ligjin për Falimentimin, përkatësisht nenin 46 për Arritshmërinë e të gjitha kërkesave, kërkesat e pa arritura (pamaturuara) do të konsiderohen të arritura (maturuara) në momentin kur gjykata vendos për hapjen e rastit të falimentimit. Rrjedhimisht, çdo lloj interesi do të ndërpritet me hapjen e rastit për falimentim dhe e gjithë shuma do të konsiderohet e pagueshme në atë moment.

Në ligj përmenden dy lloje të kërkesave të kreditorëve: **kërkesat e siguruara** dhe të **pasiguruara**. Një kërkesë konsiderohet e siguar deri në vlerën e kolateralit që siguron pagesën e asaj kërkesë. Nëse kërkesa e kreditorit e tejkalon vlerën e kolateralit që siguron pagesën e kërkesës, konsiderohet se kreditori për pagesën mbi vlerën e kolateralit ka kërkesë të pasiguar.

Secili kreditor duhet ta regjistrojë kërkesën dhe provat mbi ekzistimin e kërkesë në gjykatë, me qëllim të vërtetimit të vlefshmërisë dhe vlerës së kërkesës.

Në **procedurë të likuidimit**, kreditori duhet të **regjistrojë kërkesën** në afatin prej **60** ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.

Në një **procedurë të riorganizimit**, përveç kur gjykata urdhëron ndryshe për shkak të nevojave të procedurës së riorganizimit, kreditori duhet të regjistrojë kërkesën brenda **30** ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.

Kompensimi i kërkesave të kreditorëve

Kërkesat që paguhen së pari janë kërkesat e siguruara që përcillen nga pagesa e kërkesave të pasiguruara. Të gjitha kërkesat e pasiguruara supozohet se kanë prioritetin e njëjtë për qëllime të shpërndarjes. Megjithatë, prioritetet e pagesës së kërkesave të pasiguruara radhiten në këtë mënyrë:

1. shpenzimet administrative (të gjitha shpenzimet për administrimin e rastit duke përfshirë pagesën e administratorit);
2. kërkesat që rrjedhin nga marrëdhëniet familjare ose kërkesat për kompensim të viktimave;
3. kërkesat nga marrëdhënia e punës;
4. kërkesat tatimore;
5. çfarëdo kërkesë e mbetur e pasiguar

Administratori (personi i emëruar si përfaqësues i pasurisë së falimentimit) paguan shpenzimet administrative si prioritet i parë në mesin e kërkesave të pasiguruara.

Riorganizimi dhe Likuidimi

Ligji për Falimentimin parasheh dy lloje të procedurave të falimentimit: Riorganizimin dhe Likuidimin.

Riorganizimi në bazë të definicionit ligjor është procesi përmes të cilit tentohet të vendoset situata e mirë dhe e qëndrueshme financiare e biznesit të debitorit, të ruhen vendet e punës dhe biznesi të vazhdoj operimin. Riorganizimi mund të aplikohet në forma të ndryshme duke përfshirë **faljen e borxheve, shndërrimin e borxheve në ekuitet për kreditorin dhe shitjen e biznesit ose pjesëve të biznesit**.

Ligji thekson se në secilin rast ku **NVM** paraqitet si **debitor**, ai duhet të trajtohet si **rast i riorganizimit**. Në secilin rast të **NVM**-ve, NVM duhet të paraqes planin e riorganizimit brenda **30** ditëve nga dita e inicimit të procedurës së falimentimit. Në këtë aspekt, ligji e përshkruan edhe nocionin e monitoruesit i cili emërohet nga gjykata në secilin rast ku përfshihet një NVM në cilësi të debitorit falimentues. Roli i monitoruesit është të këshillojë debitorin në lidhje me rrjedhën e biznesit, perspektivat e biznesit dhe mundësinë e përgatitjes së një plani të

riorganizimit i cili do të jetë i pranueshëm për kreditorët.

Në anën tjetër, **likuidimi** nënkupton procedurat për shitje të pronave dhe asetëve të debitorit me qëllim të shpërndarjes së mjeteve ndaj kreditorëve. Kjo ndodh kur debitori nuk mund të rimarr veten dhe zgjedh lirimin nga borxhet dhe mbylljen e rastit, gjë e cila dërgon në shuarjen e biznesit.

Gjykata cakton një Administrator në afatin jo me vonë se 3 ditë në këto raste:

- pas dorëzimit të kërkesës për likuidim nga debitori;
- pas hapjes së procedurës së likuidimit sipas kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit të bërë nga kreditorët;
- pas shndërrimit të riorganizimit në likuidim;
- pasi që gjykata e shkarkon debitorin në posedim ose një Administrator të emëruar më herët.

Lirimi nga borxhet dhe mbyllja e rastit

Lirimi nënkupton shlyerjen e borxheve dhe sipas Ligjit për Falimentimin:

- zhvlerëson çfarëdo aktgjykimi të nxjerr në çfarëdo kohe, aktgjykim i cili krijon përgjegjësi të plotë personale për debitorin ndaj një kërkesë, për të cilat debitori ka pranuar lirim;
- ka efektin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës dhe vepron si ndalesë ndaj fillimit ose vazhdimit të çfarëdo procedure ose veprimi kundër debitorit për mbledhje të borxhit, për kthim të borxhit ose për çfarëdo kërkesë për kompenzim, pa marrë parasysh se a ka pasur debitori përgjegjësi të plotë personale ndaj atij borxhi.

Debitori do të lirohet nga borxhet ndaj të gjitha kërkesave që kanë ekzistuar deri:

- në momentin e konfirmimit të planit të riorganizimit; ose
- deri në momentin e mbylljes së rastit të likuidimit ose njoftimin e regjistrimit të bizneseve dhe administratës tatimore mbi mbylljen e rastit, cilado nga këto të ndodh e fundit.

Debitori individual, nuk lirohet nga borxhi nga cilado prej:

- kërkesave që nuk kanë të bëjnë me aktivitete afariste të debitorit;
- kërkesave nga marrëdhëniet familjare;
- kërkesave nga kompenzimi i viktimave të dhunës;
- kërkesave tatimore të krijuara për periudhën një vjeçare nga dita e hapjes së rastit;
- kërkesave të papërfshira në listën e kërkesave të dorëzuara;
- kërkesave për të cilat kreditori nuk ka pranuar njoftim të rregullt dhe si rezultat nuk ka mundur t'i dorëzojë gjykatës kërkesën dhe dëshmitë në kohë;
- kërkesave që kanë lindur si rezultat i mashtrimit nga debitori;
- kërkesave që kanë lindur si rezultat i shkeljes së detyrimit për mirëbesim të debitorit;
- kërkesave që nuk rezultojnë nga kontratat por të cilat janë krijuar si rezultat i dëmtimit të qëllimshëm të shkaktuar nga debitori ndaj një entiteti tjetër ose pronave të një entiteti tjetër.

Falimentimi Ndërkombëtar

Ligji për Falimentimin ka një kapitull të veçantë me të cilin rregullon falimentimin ndërkombëtar dhe është i aplikueshëm për degët e shoqërive të huaja tregtare.

Ky kapitull zbatohet në rastet kur:

- një gjykatë e huaja ose nga një përfaqësues i huaj i pasurisë falimentuese i kërkon ndihmë gjykatës kompetente në Kosovë në lidhje me një procedurë të huaj falimentuese; ose
- kërkohet ndihmë në një shtet i huaj në lidhje me procedurat e falimentimit sipas këtij Ligji; ose
- një procedurë e huaj e falimentimit dhe një procedurë e falimentimit sipas këtij ligji janë duke u zhvilluar në të njëjtën kohë; ose
- kreditorët ose personat tjerë të interesuar në një shtet të huaj kanë interes për të kërkuar fillimin e procedurës ose pjesëmarrjen në procedurë sipas këtij Ligji.

Konkluzionet

Ligji i ri për Falimentimin e përmirëson legjislacionin komercial në Kosovë duke sjellë një sistem modern dhe praktika të cilat nuk kanë mundur të zbatohen më herët për shkak të mungesës së dispozitave ligjore.

Kjo kornizë e re ligjore duhet të shfrytëzohet nga bizneset si dhe në anën tjetër është e nevojshme për gjykatën që të zbatojë në përpikëmeri dispozitat e Ligjit të ri për Falimentimin në mënyrë që të rris besimin e investitorëve vendor dhe të huaj.

Pasiçë akoma nuk ka shumë raste të zhvilluara nga gjykatat dhe procedura e falimentimit akoma nuk shihet si mjet i përshtatshëm nga kreditorët por as nga debitorët, duhet të punohet në ndërtimin e kapaciteteve të gjykatave, administratorëve dhe të gjithë akterëve relevant për të rritur

sigurinë ligjore për palët që futen në procedurat e falimentimit.

Referencat

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2016) Ligji Nr. 05/L - 083 për Falimentimin

Raporti "Të bërit Biznes" 2016, Banka Botërore

USAID CLE, Broshura për Ligjin për Falimentimin (Janar 2017)

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 2003/4 për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridik në Falimentim